Lezhë, më 29.08.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, më dt. 29.08.2022, në orën 13:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen e radhës të muajit Gusht 2022

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

Kërkoi fjalën z. Agostin Marku

Agostin Marku: kisha diçka në lidhje me pikën 7 të rendit të ditës. Si rregull kjo është pika e parë e rendit të ditës.

Së dyti, ne e shtymë mbledhjen e kaluar për ta bërë sa më mirë dhe pikërisht përveç informacionit që ishte depozituar, nuk është depozituar asnjë informacion shtesë. Ndoshta e kemi live, ose më mirë. N.q.s nuk e kemi live dhe kemi ardhur me të njëjtin mendim, tërhiqemi prapë se unë nuk e kam për ego por e kam që të përmirësohet puna.

Ndue Luli: Për pjesën live nuk kemi pse diskutojmë ndërsa për rendin e interpelancës, këtë e kemi në dorë. Si mendoni.

Pjerin Ndreu: kam unë diçka.

Agostini ka të drejtë se ne jemi në kuadrin e mbylljes së sezonit dhe nuk na kanë ardhur të dhënat e pushimit. Për të pasur një informacion më të plotë dhe për të

përpshirë edhe të dhënat e sezonit turistik, mendoj ta shtyjmë nga fundi i shtatorit, për të bërë një bilanc real të situatës.

Agostin Markaj: Unë jap mirëkuptimin e plotë për ta shtyrë, por kam kërkuar shifrat e vitit 2021 edhe shifrat e 6-mujorit të parë të vitit 2022. N.q.s. i shërben punës, absolutisht nuk kam asnjë vërejtje, e shtyjmë.

Pjerin Ndreu: Ne kemi krijuar një sistem të ri pune aty, me staf të ri. Jemi duke kalkuluar të gjitha shifrat. Pesha kryesore të të ardhurave e të sezoni turistik. Jemi duke prokuruar edhe sistemin online për të arritur deri te familje më e largët. Në fund të shtatorit mund të kemi një panoramë më të plotë të të gjitha detajeve që kërkohen.

Ndue Luli: Atëherë, duke u nisur edhe nga kërkesa i interpelancës, a jemi dakord që vendin e ditës ta miratojmë pa pikën 7? Kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent.

Fillojmë me pikën 1 të rendit të ditës që është projekt-vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 korrik 2022".

E hedhim në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 2 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e marrëveshjes dhe pjesëmarrjen e Bashkisë Lezhë në subjekte me kompetence të përbashkëta me qëllim kryerjen e shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura"

Materialet i keni patur të gjithë.
Kush ka diçka në lidhje me këtë p/vendim.
→ Erdhën këshilltarët Klejvi Hoxhipi dhe Riner Danaj.
Agostin Marku: Më lejo. Unë nuk kuptoj diçka këtu. Autorizimin e kryetarit të Bashkisë për të autorizuar drejtorin. Ndoshta e kam kuptuar unë gabim, te pika 2 e p/vendimit. Ndoshta jam unë gabim (lexon pikën 2).
Pjerin Ndreu: Kjo është faza e dytë që ne e miratojmë, pas ky do autorizohet për të nënshkruar këtë marrëveshje. Atë do autorizoj. (drejtorin e Ujësjellësit).
Agostin Marku: Ti mund të autorizosh kë të duash. Pse duhet të hyjmë ne te administratori.
Pjerin Ndreu: Kjo është një procedurë pas pak e shumë ne ka ardhur e gatshme.
Të gjitha bashkitë kështu kanë vepruar
Çështje e autorizimit - edhe po ta miratojmë, më mirë është. dhe shkelje nuk ka.
Agostin Marku: Ti te pjesë e parë nuk duhet

të përmendësh as emrin tënd. Bëjeni vendimin funksional.

Kërkoi fjalën znj. Flora Dedgjonaj, Specialiste në Drejtorinë Juridike në Bashki, e cila tha: Emri është përmendur në cilësinë e aksionerit, sepse është shoqëri aksionere, ndërsa për sa i përket autorizimit të administratorit të shoqërisë aksionere Ujësjellës Kanalizime për krijimin e subjektit me kompetenca të përbashkëta, për kalimin e aseteve dhe veprimtarisë ekonomike, përmendet emri i tij Maçi sepse ka një QKB, ka një administrator të shkruar që nëse ndryshon, do bëhen ndryshimet e posaçme në QKB, pastaj të reflektohen ato nëse është e nevojshme, në vendimmarrje apo në marrëveshje. Akt-marrëveshje ka ardhur e firmosur nga ministria përkatëse, ka ardhur drafti dhe fhyesit janë bërë kredencialet e nevojshme nga ana jonë. Është një iniciativë e politikave qeveritare për përmirësimin e shërbimit, që thjesht po ndjekim hapat e nevojshëm. Unë nuk shoh asnjë kundërligjshmëri në pikën 2 të këtij p/vendimi.

Ndue Luli: Meqë nuk ka ndonjë mendim tjetër, e hedhim projektit vendimin në votim. Kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që abstenoi.

Kalojmë te pika 3 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kontingjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të papaguara që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor".
Agostin Marku: Në parim jam shumë dakord. Është një shumë e mirë pastrimi i kontabilitetit dhe financave nga detyrimet e tilla. Unë i kam hedhur një sy dhe kam parë aty një rast për vendim gjykate. Në shumë raste përmendet shumë të dhëna, pastaj thuhet mungon dokumentacioni. N.q.s ka pasë një procedurë tenderi dhe n.q.s ka dhe një akt të marrjes së punës në dorëzim, mund të vihen njërëzit para përgjegjësisë se nga verifikimet në vend s'është kryer asjo punë dhe s'kemi pse ta likuidojmë, por të shkojmë direkt në heqjen e tyre, kam frikë se mos me procedura gjyqësore, do i dalë më punë bashkisë sesa ky vendim që marrim ne sot.
Pjerin Ndreu: Bëhet fjalë për një problem shumë të madh që është mbartur nga reforma

territoriale. Diku 1,8 mld të tjetra janë janë borxhe të ish komunave. Ne kemi bërë një vlerësim. Nëse unë dua t'i likuidoj nesër, si ta kapim dokumentacionin që t'i likuidoj. Të gjitha këto procedura që kemi identifikuar ne jemi me mangësi. Nëse dikush shkon në gjykatë dhe fiton, ne normalisht që do i jepim lekët. Por ne nuk mund t'i mbartim më si borxhe të vdekura aty. Le që unë nuk kam ndonjë kërkesë për likuidimin e tyre.

Kërkoi fjalën Z. Xhemal Hoxha (specialist i buxhetit) i cili tha: Bilancet e vitit 2015 të ish komunave janë mbyll pa dokumenta. 2015 - 2022 i thonë 7 vjet dhe s'ka paraqitur asnjë kërkesë. Një vendim gjykate është përfshirë në bilanc, por nuk e dimë cili është, s'kemi asnjë lloj dokumenti. Ky difekt ka ardhur edhe nga ata që kanë mbyllur bilancet e ish komunave, ekspertët. Ne e dimë shumë mirë, që të regjistrohet në kontabilitet duhet të ketë dokument justifikues. Dokumenta s'ka fare. Janë verifikuar një për një të gjitha. Kemi rastin e shpronësimeve. Janë futur vlerat e shpronësimeve por s'ka asnjë dokument. Ne kemi menduar që mos t'i mbajmë si ngarkesë, mos të trajtohemi si borxhi me detyrime të prapambetura padrejtësisht dhe të pastrohet bilanci.

Pjërin Ndreu: Unë mendoj se është fund e kujdesshme e bashkisë për të çliruar veten nga ngarkese pa lidhje. E tre dhe Khemeli, kur kanë mbyllur bilancet, s'merret vesh se çfarë kanë bërë. Me këtë ne i shërbejmë bashkisë, sepse duhet i hequr këto detyrime ne shlyejmë në një shifër shumë të ulët të borxhit.

Ndue Luli: Atëherë e kalojmë në votim
Kush është dakord me projekt-vendimin?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kalojmë te pika 5 e rendit të ditës që është projekt-vendim për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2022"
Unë tërhiqem nga votimi meqë kam konflikt interesi, në bazë të ligjit dhe të rregullores.
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë përveç z. Ndue Luli që deklaroi konflikt interesi.
Kalojmë te pika 6 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e dorëheqjeve të disa kryetarëve të fshatrave".

Agostin Marku: Jemi në fund të mandatit. Ti emërojë kryetari i Bashkisë.

Ndue Luli: E hedhim në votim
kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Kërkoi fjalën z. Pjerin Ndreu i cili tha:
Të gjithë këshilltarëve të Ungrejt dhe atyre
që kanë lidhje me Ungrejin, u jap lajmin
se në shtator fillon rruga. Është prokuruar,
është shpallur fituesi.
Ndue Luli: Kalojmë te pika "Të ndryshme".
Argjentjana Noka: Në lidhje me shërbimet publike.
Kryetar, atje te lagjja, atje ku po bëhet ura
e re, banorët e lagjes i hedhin inertet
atje jashtë. Të vijnë t'u thonë që mos t'i
hedhin më. Duke djegur bonshketet, kanë
djegur dhe 2 koshat. Nuk ke faj drejtori
i Shërbimeve, por ose t'u çojmë fjalë që
mos t'i hedhin më, ose të gjobiten nga bashkia.
Ndue Luli: Meqë ishim te shërbimet kryetar,
kisha diçka edhe unë. Afër bustit të
Papa Gjon Palit II, është një rrugë që është
lënë pa tabelë. Është rruga klinika Tuci, te
klinika e doktor Naim Hajdarit. Është
shqetësim i banorëve atje.
Rigels Nica: Në Ishull Lezhë po bëhet
një gjë e bukur me rrugën që do jetë
vetëm për biçikletat. Thjesht të respektohet
gjerësia e duhur dhe e shoh të nevojshme

ose me ndonjë tabelë shpejtësie, ose me
ndonjë bum për makinat.
Tjetër, është planifikuar rruga e shkollës
së Ishullit, sepse po fillon viti shkollor...
Pjerin Ndreu: Duhet të kemi parasysh diçka
në lidhje me rrugët sepse kemi ndryshuar të
gjitha çmimet. dhe kanë mbetur. Gjithashtu
dhe shtëpitë e tërmetit kanë mbetur.
E kemi këtë problem dhe në shtator do t'i
gjejmë rrugëzgjidhje. Por mos të nxitojmë
të bëjmë gjënë shkel e shko.
Janë një bllok-rrugësh që i kemi miratuar me
buxhetin, në Dajç, në Blinisht, në Zejmen,
në Spiten, në Shënkoll, në të gjitha zonat tona.
Rigels Nicaj: Ka shtratra ku nuk është vënë
dorë në lidhje me pastrimin e kanaleve.
sepse nuk vjen boti.
Pjerin Ndreu: Do i gjejmë zgjidhje.
Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera,
mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI